




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.306/2022
Datë: 23 qershor 2022

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 7 paragrafi 1, pika 1.14 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, duke vendosur në çështjet disiplinore ndaj Tatijana Virijević, Gjyqtare Mbikëqyrëse në Gjykatën Themelore në Mitrovicë-Dega në Leposaviq dhe Dragica Jakovljević, Gjyqtare Mbikëqyrëse në Gjykatën Themelore në Mitrovicë - Dega në Zubin Potok, sipas Raportit të panelit hetimor Nr.AD/KGJK/11/2022/GJTHM - AD/GJTHM/09/10/2022, dhe marrëveshjeve vullnetare për pranimin e fajësisë për shkeljen e supozuar, të datës 20 qershor 2022, pas shqyrtimit të bërë në pajtim Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe bazuar në nenet 19 dhe 20 të Rregullores (05/2019) për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, në seancën e mbajtur më datë 23 qershor 2022, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet** marrëveshja vullnetare për pranimin e fajësisë për rastin disiplinor Nr.AD/KGJK/11/2022/GJTHM-AD/GJTHM/09/10/2022, të lidhur në mes të panelit hetimor dhe subjekteve të hetimit disiplinor Tatijana Virijević, Gjyqtare Mbikëqyrëse në Gjykatën Themelore në Mitrovicë - Dega në Leposaviq dhe Dragica Jakovljević, Gjyqtare Mbikëqyrëse në Gjykatën Themelore në Mitrovicë - Dega në Zubin Potok.
- II. Tatijana Virijević, Gjyqtare Mbikëqyrëse në Gjykatën Themelore në Mitrovicë-Dega në Leposaviq dhe Dragica Jakovljević, Gjyqtare Mbikëqyrëse në Gjykatën Themelore në Mitrovicë-Dega në Zubin Potok, janë përgjegjëse për shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 2, pika 2.16, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.
- III. Për shkeljen disiplinore të vërtetuar si në pikën II të këtij vendimi Tatijana Virijević, Gjyqtare Mbikëqyrëse në Gjykatën Themelore në Mitrovicë-Dega në Leposaviq dhe Dragica Jakovljević, Gjyqtare Mbikëqyrëse në Gjykatën Themelore në Mitrovicë-Dega në Zubin Potok i shqiptohet sanksioni disiplinor zvogëlim i përkohshëm i pagës në lartësi prej tridhjetë për qind (30%) në kohëzgjatje prej katër (4) muajve, të përcaktuar me dispozitën e nenit 7, paragrafi 1, pika 1.3 të të njëjtit Ligj.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me datë 20.04.2022, ka pranua nga Autoriteti Kompetent përkatësisht ushtruesi i detyrës së Kryetarit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore ndaj Tatijana Virijević, Gjyqtare Mbikëqyrëse në Gjykatën Themelore në Mitrovicë-Dega në Leposaviq dhe Dragica Jakovljević, Gjyqtare Mbikëqyrëse në Gjykatën Themelore në Mitrovicë-Dega në Zubin Potok, me pretendimin se kanë bërë shkelje disiplinore për gjyqtar të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 2, të lidhur me nën paragrafin 2.11 dhe 2.16, që përcakton ndalimin e angazhimit në ndonjë aktivitet politik që është në kundërshtim me detyrat e gjyqtarit sipas Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Pas shqyrtimit të kërkesës për fillim të hetimeve, Këshilli me vendimin KGJK.nr.157/2022, të datës 20 prill 2022, ka themeluar panelin hetimor për lëndën disiplinore Nr.AD/KGJK/11/2022/GJTHM-AD/GJTHM/09/10/2022.

Paneli hetimor pasi ka përfunduar hetimin disiplinor, me datë 20.06.2022 i ka dorëzuar Këshillit raporti mbi faktet dhe provat e mbledhura dhe marrëveshjen vullnetare të arritur në mes të panelit dhe subjekteve të hetimit disiplinor.

Për panelin hetimor ka qenë e pakontestueshme se subjektet e hetimit me këtë rast Tatijana Virijević dhe Dragica Jakovljević, kanë kryer shkelje disiplinore me pjesëmarrjen e tyre në takimin e datës 22.03.2022, me ftesë të presidentit të Republikës së Serbisë, ku prezent kanë qenë dhe përfaqësuese të tjerë politik, duke vlerësuar se ky takim ka qenë i natyrës politike, marrë parasysh se në atë kohë kanë qenë edhe zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale në Serbi. Gjatë procedurës tek paneli hetimor subjektet e hetimit dhe paneli hetimor kanë arritur marrëveshje vullnetare për shkeljen e supozuar me të cilën kanë pranuar përgjegjësinë disiplinore për të cilat janë ngarkuar nga Autoriteti Kompetent.

Për këtë shkelje të pranuar janë pajtuar që të ju shqiptohet sanksioni disiplinor zvogëlim i pagës për tridhjetë përqind (30%) në kohëzgjatje prej katër (4) muajve, siç është përcaktuar në nenin 7, paragrafi 1, nën paragrafi 1.3, të të njëjtit Ligj. Me rastin e dakordimit për sanksionin disiplinor paneli si rrethanë lehtësuese morri atë se subjektet e hetimit nuk kanë pasur me herët ndonjë masë disiplinore të shqiptuar.

Për të shqyrtuar raportin dhe marrëveshjen vullnetare për pranimin e fajësisë, Këshilli me datë 23 qershor 2022, ka caktuar dhe mbajtur seancë.

KGJK, vlerësoi se marrëveshja vullnetare e lidhur në mes të Tatijana Virijević, Gjyqtare Mbikëqyrëse në Gjykatën Themelore në Mitrovicë-Dega në Leposaviq dhe Dragica Jakovljević, Gjyqtare Mbikëqyrëse në Gjykatën Themelore në Mitrovicë-Dega në Zubin Potok dhe panelit hetimor, së bashku me dakordimin e tyre për llojin e sanksionit disiplinor të përcaktuar në nenin 7, paragrafi 1, pika 1.3, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, i përmbush të gjitha kushtet ligjore dhe se edhe sanksioni i propozuar nga ana e tyre është i drejtë dhe në proporcion me shkeljen disiplinore të tyre.

Sipas vlerësimit të Këshillit, sanksioni disiplinor për të cilin janë dakorduar paneli dhe subjektet e hetimit, ka konsumuar shkelje disiplinore të pretenduar nga Autoritetit Kompetent, andaj si të tillë edhe e aprovoj.

KGJK-ja e ka pranuar marrëveshjen vullnetare duke vlerësuar faktin se paneli hetimor ka të drejtën e ofrimit të marrëveshjes subjektivit të hetimit si mënyrë e përfundimit të procedurës disiplinore, por pa e ndryshuar kualifikimin e shkeljes e cila pretendohet me kërkesës për inicimin e procedurës disiplinore, gjë që nënkupton se marrëveshja e arritur në procedurën disiplinore i referohet shkeljeve nga neni 5, paragrafi 2, pika 2.11 dhe 2.16, të përcaktuar në Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Vendimi u mor njëzëri nga ana e anëtarëve të pranishëm të Këshillit Gjyqësor.

Me sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KGJK.nr.306/2022, datë 23 qershor 2022

Albert ZOGAJ,

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese brenda 15 ditëve, pas pranimit të vendimit drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Ljiljana Stevanović, *Kryetare, Gjykata Themelore në Mitrovicë;*
- Tatijana Virijević, *Gjyqtare Mbikëqyrëse në Gjykatën Themelore në Mitrovicë-Dega në Leposaviq;*
- Dragica Jakovljević, *Gjyqtare Mbikëqyrëse në Gjykatën Themelore në Mitrovicë-Dega në Zubin Potok;*
- *Arkivit.*